

QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara



ÇFARË DUHET TË DIMË DHE NË
ÇFARË MËNYRE TË SILLEMI NDAJ
PERSONAVE ME
**PARALIZË
CEREBRALE?**

Paraliza cerebrale ka shumë fytyra dhe të gjitha janë të buzëqeshura!

Nuk ka dy fytyra me paralizë cerebrale që janë të njëjtë, njëllon sikur edhe njerëzit. Disa mund të ecin, nga ana tjetër, disa janë në karroce invalidore – të gjithë jemi të ndryshëm, të ngjashëm sikur të gjithë



njerëzit!

Unë mund të kuptoj, të shikoj dhe të dëgjoj gjithçka, por ndoshta ndonjëherë nuk do të mund të përgjigjem në mënyrën në të cilën shpreson, shpesh kam probleme të shpreh emocionet e mia në mënyrë në të cilën je mësuar dhe që i ke të njohura ti.

Gjithçka që ti e ke të lehtë ta bësh, për shembull, të pish ujë, të ulesh në karrige, të shkruash emrin tënd, unë duhet të përsëris së paku 10.000 herë që ta mësoj. Sado herë që të përsëris, disa hapa, për fat te keq, nuk do të mund t'i bëj pavarësisht dhe gjithë jetën do të kem nevojë për ndihmë.



Komuniko me mua në mënyrën që komunikon me gjithë të tjerët dhe ki durim!

Madje edhe të folurit është "lëvizje" dhe asnjëherë nuk do të jem në gjendje të përgjigjem në gjuhë të kuptueshme për ty. Për të më ndihmuar, mund të më tregosh, të parashtrosh pyetje të cilave mund t'ju përgjigjem shkurtimisht, të më tregosh kartolina, por mos harro, çdoherë bëje atë me respekt, sepse ndonëse të kuptoj tërësisht, e kam të vështirë të përgjigjem.

Unë mund të bëj gjithçka por në mënyrë të ndryshme dhe me ndihmë. Nëse mundesh, më ndihmo!



Paraliza cerebrale ndikon mbi mundësinë time të lëviz, por inteligjenca ime, personaliteti, ndjenja për humor, dëshirat dhe ëndrrat janë të ngjashme me ato që ke ti.



Qetësohu! Paraliza cerebrale nuk është ngjitëse!

Paraliza cerebrale nuk është sëmundje. Askush nuk mund të infektohet ose të shërohet nga paraliza cerebrale. Ajo është lëndim i trurit. Lëndimi i trurit mund të shkaktohet nga faktorë të ndryshëm!

Të gjithë jemi të ndryshëm!

Dy persona nuk mund të kenë simptoma identike. Kufizimet dallojnë në bazë të vendit dhe intensitetit të lëndimit të trurit.



Lëvizja është një sfidë vetëm nëse nuk kemi ndihmesa!

Një fëmijë mund të ketë paralizë cerebrale, por edhe të ecë. Secili fëmijë ose person me paralizë cerebrale duhet të përdorë karrocë invalidore që të jetë i lëvizshëm. Disa mund të ecin dhe të përdorin ndihmesa të ndryshme, si për shembull, paterica, mjete për ecje dhe ndihmesa të tjera.

Unë jam inteligjent!

Aftësia e kufizuar intelektuale dhe paraliza cerebrale janë dy pengesa të ndryshme në zhvillim. Ndonjëherë personat me paralizë cerebrale, gjithashtu, kanë edhe aftësi të kufizuar intelektuale, por në shumë raste, ata kanë koeficient mesatar ose mbi mesatar të inteligjencës.



Paraliza ime cerebrale është unike!

Personat me paralizë cerebrale mund të kenë edhe pengesa të kombinuara që paraqiten për shkak të gjendjes, andaj, ata mund të kenë probleme me shikimin, dëgjimin dhe/ose vëmendjen. Por sërish, secili është i ndryshëm, dhe ndonjëherë edhe personi me paralizë cerebrale mund të ketë dëgjim, shikim, dhe vëmendje të shkëlqyer.



**Të folurit e kam
sfidë, por sërish,
mund të gjej-
më një mënyrë
që të komu-
nikojmë nëse
mundohe mi!**

Pengesat në të folurit paraqiten shpesh tek personat që kanë paralizë cerebrale. Pengesat në të folurit do të thotë që mund të jetë pak vështirë të kuptohet të folurit e personit ose mos të flet aspak.





Për fat të mirë, teknologjia dhe inovacionet ju kanë dhënë personave me pengesa të ndryshme në të folurit mundësi për komunikim. Vetëm kini durim, jini të kuptueshëm në të folurit tuaj dhe dëgjoni. Bëhuni kreativ, mund të merremi vesh që të komunikojmë me sytë ose të bëjë lëvizje me duart që të mund t'ju përgjigjem pyetjeve që i parashtron. Vetëm duhet dëshirë!

Ndonëse trupi im është i shëndoshë, ndonjëherë nuk mund ta kontrolloj në mënyrën që dëshiroj, mos më shiko çuditshëm, jo çdoherë e kam kontrollin mbi trupin tim!

Ndonëse duket sikur kam probleme me trupin (këmbët, duart, trupin, etj.) në fakt trupi im është identik i shëndosh sikur edhe trupi yt. Unë kam vështirësi në ecje që është pasojë e lëndimit tim në tru. Paramendo një kompjuter që nuk punon mirë.

E shtyp butonin e djathtë, por ndonjëherë nuk ka reagim dhe veprim. Unë çdoherë e dërgoj mesazhin e drejtë në tru, por

muskujt ndonjëherë nuk e marrin mesazhin e drejtë që kam dashur të dërgoj. Kjo vlen për gjithçka!

Ndonëse kam aftësi të kufizuar, sërish jam person me nevoja!

Fëmija me paralizë cerebrale sërish është fëmijë. Ngjashëm me gjithë të tjerët, ka nevojë për dashuri, udhëheqje, mbështetje, lojë, kreativitet dhe rregulla. **MOS TË VIJË KEQ PËR MUA!** Nuk ka nevojë për ndonjë trajtim të veçantë vetëm sepse kam nevojë të vazhdueshme për ndihmë nga dikush.

Nuk ka ende barë për paralizë cerebrale, por ajo nuk na ndalon që të shpresojmë se do të gjendet!



Terapia fizikale, mentorimi profesional, terapitë e të folurit dhe terapitë në ujë janë të shkëlqyeshme për personat me paralizë cerebrale. Ata ndihmojnë në përforcimin e muskujve dhe ndihmojnë për kontroll më të mirë.

UNË MUNDEM GJITHSKA!



Disa persona që kanë probleme me paralizën cerebrale mund të drejtojnë makinë, të tjerët jo. Përshtatjet e makinave mund të mundësojnë këtë, por ndonjëherë spasticiteti dhe lëvizjet e padëshiruara e vështirësojnë drejtimin e makinës - së paku deri sa teknologjia të përmirësohet.



Unë mund të kalëroj dhe të drejtoj biçikletë!



Lëvizjet e kalit janë në mënyrë të dëshmuar të ngjashme me ato që në mënyrë statike e bënë trupin të lëviz. Kalërimi më ndihmon të ndiej gravitacionin në mënyrën në të cilën e ndjen edhe ti! Biçikleta më ndihmon të përforcoj muskujt, të kem aktivitete argëtuese!



Mundem dhe dëshiroj të shkoj në shkollë!

Personat me paralizë cerebrale mund të kyçen në mësimdhënien e rregullt, por kuptohet me rëndësi është të sigurohet hapësirë e përshtatur.

Dëshiroj të punon dhe mund të punoj!



Personat që kanë paralizë cerebrale zakonisht dëshirojnë të punojnë, por kompanitë shpesh i diskriminojnë dhe nuk i punësojnë. Ëndrrat e mia profesionale për realizim janë identike me ato që ke ti, do të dëshiroja të fitoja financiarisht dhe të siguroj një jetë më të mirë për familjen time.

Unë dëshiroj të kem familje, dhe kam të drejtë për atë!

Gratë dhe burrat me paralizë cerebrale mund të kenë fëmijë, ndërsa gratë mund të kenë shtatzëni të shëndoshë. Paraliza cerebrale nuk është gjenetike dhe nuk ndikon mbi foshnjën e pa lindur.



Në çfarë mënyrë të ndihmohesh kur të takohemi!

Nëse më shikon që lëviz ngadalë dhe me vështirësi në ecjen, nëse takohemi, më siguro hapësirë të mjaftueshme!




Nëse kam vështirësi të ngrihem nga ndonjë karrige, më ndihmo, por në fillim më pyet, ndoshta vetëm kam nevojë për më shumë kohë!

Nëse karroca ime nuk mund të ngjitet në trotuar, mund të më pyesësh nëse kam nevojë për ndihmë, dhe nëse pranoj, më ndihmo që të tejkaloj pengesat që gjenden në rrethinë (trotuar, shkallë ose të ngjashme).



Lëvizje

Fëmijët dhe personat me paralizë cerebrale, ndonëse edhe nëse nuk lëvizin pavarësisht, ndonjëherë kanë nevojë të mbahen për të mbajtur baraspeshën. Shpeshherë mund të ecin të mbështetur në mur, të mbahen për gathë, ose tjera. Nëse mundesh, ofro ndihmë, por çdoherë vendosni që personi me paralizë cerebrale të përcaktojë në çfarë mënyre të lëviz!



Mundeni vetëm të qëndroni afër në rast se personi me paralizë cerebrale të humb baraspeshën, dhe ju ndihmoni që të kthehet sërish. E njëjta vlen edhe për fëmijët!

Përshëndetja

Dua të më përshëndetësh në mënyrën e njëjtë sikur edhe të tjerët, por ndonjëherë nuk do të mund të jap dorën dhe që do të thotë që mos të më përkëdhelësh në kokë! Nuk jam foshnje dhe as kafshë. Ndoshta do të arrij të të përshëndes në mënyrën e vetme që unë mundem të shpreh. Mund edhe të marrësh dorën time dhe të më ndihmosh të përshëndetemi.




Sekretimi

Ndonëse jam i rritur, ndonjëherë mund të ndodh që mos të kontrollojë sekretimin tim! E kuptoj që është e vështirë për të shikuar, më ofro facultetë! Ndonëse nuk je rehat, shikimi yt dhe reagimi mund të më turpërojnë, andaj mund të kem më tepër problem me sekretimin tim!

Ndihma e parësh

Një prej katër personave me paralizë cerebrale ka epilepsi, që është një gjendje serioze. Nëse kam sulm epileptik, vlenë rregullat e njëjta për ndihmë të parë. Asnjëherë në asnjë rast mos u mundo të nxjerrësh gjuhën time. Më ndihmo që të shtrihem në tokë i kthyer në krahëror me një dorë të shtrirë në tokë dhe pritni me durim të kalojë sulmi epileptik. Në ndërkohë njoftoni ndihmën e shpejtë për ndodhinë dhe me durim pritni. Mos reagoni me panikë! Paniku vetëm thellon dhe keqëson sulmin.





QENDRA E RESURSEVE
e prindërve të fëmijëve
me aftësi të kufizuara

QENDRA E RESURSEVE

rr. Vasko Karangeleski 33

1000 Shkup

++389 78 449 851

++389 78 449 852

www.resursencentar.mk

Hartimi i broshurës është mundësuar me mbështetjen financiare e UNICEF-it, në kuadër të projektit: "Rritja e Mundësive për Inkluzion dhe Përmirësimi i Cilësisë së Jetës së Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara me anë të Fuqizimit të Prindërve dhe Familjeve të Tyre".



Qëndrimet e shprehura në këtë broshurë janë vetëm të autorëve dhe nuk duhet patjetër të përputhen me qëndrimet dhe politikatat e UNICEF-it.